

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 37, datë 31.03.2026

PËR

MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL LIFE INSURANCE GROUP” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë të Administrimit të Riskut dhe Modeleve Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike të shoqërisë “SIGAL LIFE INSURANCE GROUP” SH.A., siç paraqiten në 31 dhjetor 2025, sipas përlogaritjes së shoqërisë.
2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2025 të provigjoneve teknike dhe matematike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:

Provigjonet teknike dhe matematike në 31 dhjetor 2025	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	1,762,503,725
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>16,190,136</i>
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	1,746,313,589

3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI